



BASHKIA MIRDITË

Rreshen, më _____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE AUTOMJETI PËR AGJENCINË E PUNËVE
PUBLIKE DHE MIRËMBAJTJES DHE SEKTORIN PYJOR, BASHKIA MIRDITË”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT
(CPV):43000000-3**

VLERA E FONDIT LIMIT: 15 733 333 (Pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Mirditë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojces 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave

për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se:

Pika 1 Neni 83: “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*”

Pika 2 Neni 83: “*Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës”,

si dhe në nenin 30 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Kopje të certifikuara të balanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2022, 2023**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabël.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy balance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et

e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”¹. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve **(2022, 2023)** lëshuar nga Administrata Tatimore, *(e cila është një vlerë jo më e madhe se dyfishi i vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet)*. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës;* në pikën 1 dhe pikën 2/a të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej në Procedurën e Hapur, përkatesisht; në pikën 2/b përcaktohet se: *”2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”*; Duke qënë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është i përshtatshëm vendosja e këtij kriterit të përcaktuar në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në:

- nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;**”*
- nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin Mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e 2 (dy) viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohej dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar *është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet*, që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:

- a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara

ose

- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e furnizimeve të mëparshme të ngjashme prej 40% të fondit të limit/ vlerës së pritshme të kontratës së parashikuar i jep siguri AK që operatorët ekonomikë kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog teknik ose fragment të katalogeve ose skedë teknike për mjetet, i cili/e cila minimalisht të përmbajë një përshkrim të karakteristikave teknike dhe të dhenave të tjera të mjetit të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

[Nëse materiali/et të cilat do të paraqiten për të përmbushur kriterin e mësipërm janë në gjuhë të huaj, ato duhet të përkthehen në shqip për pjesën e të dhënave teknike të kërkuara, si dhe të noterizuara].

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b. fotografitë apo katalogët teknikë;”*

Paraqitja e katalogjeve/skedës teknike është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmerisë së mallrave që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Autorizohet antarja e njesise se prokurimit M. Doda per hedhjen e procedures ne sistem.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane të hartuara nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin nr 194 prot., datë 16.05.2025, në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Njësia e prokurimit: